



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. 02/ 2021

Datë: 21.05.2021

Procesverbal

i mbledhjes se IV (katërt) të rregullt për vitin 2021 e Komitetit për Politikë dhe Financa

REND I DITES

1. Shqyrtimi i Raportit të DKAE-së, për përfundimin e gjysmë vjetorit të parë të vitit shkollor 2020/21.
2. Debat lidhur me Raportin e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale.
3. Shqyrtimi i kërkesave.
4. Të ndryshme.

Mbledhja u mbajt me datë: 19.04.2021 duke filluar në ora 14:50, morën pjesë 7 anëtarë të KPF-së, zyra për informim.

Rrahim Morina: Ju përshëndes të gjithëve kërkoj falje pak për vonesën, Halil Morina ka rast vdekje ka njoftua se nuk mund të merr pjesë në mbledhje. Kemi disa kërkesa dhe nese mendoni i trajtojmë një ditë tjetër. Unanimisht ishin që kërkesat të trajtohen në një mbledhje të jashtëzakonshme të Mërkurën më datë: 21.04.2021.

A jeni për rendin? Unanimisht ishin për.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Rrahim Morina: A jeni për miratimin e procesverbalit nga mbledhja e tretë? Unanimisht ishin për.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/236 datë: 08.04.2021 të parashtruar nga Kryetari i Komunës, për dhënien në shfrytëzim të pronës publike KEDS-it, divizioni i rrjetit- Departamenti i investimeve Prishtinë, për zhvendosjen e stabilimenteve të vjetra dhe vendosjen e re të stabilimenteve të nevojshme energjetike, për nevojat e vendbanimeve.

Alban Krasniqi: Parcelat në kërkesë ceken por jo saktësisht vendet ku kërkohen dhe kjo vendosja dhe zhvendosja spo kuptoj çka po zhvendoset dhe çka po vendoset.

Rrahim Morina: A jeni për që kjo kërkesë të rekomandohet për Kuvend? Unanimisht ishin për.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/235 datë: 08.04.2021 dhe marrja e vendimit për procedurë të mëtejme, për dhënien në shfrytëzim të pishinës publike në fshatin Banjë, KK- Malishevë.

Alban Krasniqi: Nuk s'kemi asnjë raport për vitin e kaluar, dy raste ja kemi falë borxhin si kuvend. Ai vend aty është aset i Komunës, atë vlerë të atyre aseteve a e ka mirëmbajt aj që ka pas në shfrytëzim apo gjendja është edhe më keq. Duhet një komision më dal aty në vend me vlerësuar gjendjen e aseteve. Me kalu dy vite pa asnjë raport nuk është në rregull.

Duhet me sjellë Raportin financiar dhe raportin mbi asetet ekzistuese në Pishinën e Banjës. Kompania e cila deri me tash e ka pas në shfrytëzim a ka bërë ndonjë investim në Pishinë, si dhe a ka qenë përfitues i pakos emergjente financiare nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Hashim Vrenezi: Jam i mendimit se kompania ska gjeneruar të hyra dhe as Komuna, pandemia është aktive hala mendoj pishinën ta menaxhojë Komuna e mos të përballemi me kërkesa.

Filloreta Bytyçi: Pandemia është evidente, operatori duhet me sjellë një raport financiar.

Alban Krasniqi: Është mirë me pas raport se në çfarë gjendje e ka lënë pishinën operatori.

Muharrem Morina: Duhet ta dini se momentin që shpallen zgjedhjet lokale më kuvendi nuk ka të drejtë me dhanë më prona në shfrytëzim.

Rrahim Morina: A jeni për që kjo kërkesë të rekomandohet për Kuvend? Unanimisht ishin për.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/161 datë:07.04.2021 të parashtruar nga DKAË, për formimin e Komisionit përzgjedhës për zgjedhjen e drejtorit dhe zëvendës drejtorit në institucionet arsimore.

Alban Krasniqi: Udhëzimi Administrativ e detyron Drejtorinë për Arsim të sjellë dy emra dhe a janë ata dy emra sipas kritereve të Udhëzimit Administrativ që t'i intervistojnë drejtorët gjatë përzgjedhjes se tyre. A ka të drejtë nënkryetari pa autorizim të kryetarit të nënshkruajë dokumente, kryesues mirë është të kërkon nga MAPL ta sqaroni këtë me ditë a ka të drejtë nënkryetari t'i nënshkruaj kontrata e drejtorëve të cilët zgjidhen nëpër shkolla.

Raimonda Krasniqi: Kush e ka bërë përzgjedhjen e atyre dy emrave që marrin pjesë në Komision.

Blerim Thaçi: Një sqarim se ne kemi kërkuar që ju ta miratoni propozimin e DKA-së, dhe jo emrat e komisionit.

Alban Krasniqi: Ka akuza për manipulim të konkurseve mirë është me na siguruar një proces që të kemi drejtor kredibil se ata dy emra që keni propozuar janë persona të partisë e në udhëzim thotë duhet me kanë ekspert të fushave.

Raimonda Krasniqi: Kandidatët duhet të jenë të lemis së Arsimit, sepse në vitin 2014 çka kanë qenë të PDK-së i keni luftuar vetëm se s'kanë qenë të partisë tuaj.

Blerim Thaçi: Nuk qëndron kjo t'i mundesh me akuzuar por s'është ashtu.

Filloreta Bytyçi: Ata dy anëtarët që i ka propozuar DKA edhe Aziz Avdiun edhe Enver Mazrekun i njoh janë të përgatitur, bile Enveri ka qenë edhe nxënës edhe student i përgatitur. Cili drejtor të zgjidhet me konkurs drejtori le të jetë me i miri e jo dikush pa asnjë kontribut.

Blerim Thaçi: Kur a shqyrtuar konkursi përfaqësuesi i MASHT ka qenë parimor.

Rrahim Morina: Kush jeni që kjo kërkesë e DKA-së të rekomandohet për Kuvend? Për ishin 2, kundër 3, abstenime nuk kishte

5. Shqyrtimi i Raportit i të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën Janar-Dhjetor 2020.

Rrahim Morina: Kush jeni që kjo pikë të rekomandohet për kuvend? Unanimisht ishin për 5 anëtarët prezent të KPF-së.

6. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për vitin 2020.

Rrahim Morina: Kush jeni që kjo pikë të rekomandohet për kuvend? Unanimisht ishin për 5 anëtarët prezent të KPF-së.

7. Shqyrtimi i kërkesave.

Kërkesa Nr.02/93 datë: 09.03.2021 të parashtruar nga z. Bashkim Dobruna nga fshati Llazicë, për marrjen e pëlqimit për shfrytëzim të ngastrës nr.P-72310043-000085-1 pronë e OTHPB-së Ekonomia e Pyjeve.

Muharrem Morina: Ai vend është në magjistralen që lidhet me Prishtinë, aty ai ka një biznes të vetin, tash Ministria i kërkon një Pëlqim të ri për parking.

Alban Krasniqi: Drejtori i Urbanizmit Ahmet Morina për një fermë të pulave që ka hapë dikush në fshatin Qypevë ka dhënë Pëlqim, në Agjencionin e Pyjeve ka me pas tash aty një auditim se aty ka pas manipulime të mëdha. Ne aty nuk mundemi me i dhanë palës pëlqim. Apo shihni njerëzit marrin tokë publike, marrin grante prej Ministrisë dhe në fund i dështon investimi. Me marrë dikush tokë në shfrytëzim ka disa kritere është plani i biznesit, me Pzhk duhet të jetë i paraparë, kjo kërkesë duhet të

refuzohet. Agjencia Pyjore është e zhytur në marrëveshje kriminale unë personalisht s'jam me u ngute dhe mi dhanë pëlqim.

Hashim Vrenezi: Të refuzohet sepse edhe një me herët e kemi pas të atij Elshanit që kërkoje pëlqim edhe nuk ja kemi dhanë.

Rrahim Morina: Kush jeni që kjo kërkesë të rekomandohet për Kuvend? Për nuk kishte, kundër 3, abstenime 3.

Palës i jepet një përgjigje se KPF unanimit e ka refuzuar kërkesën e lartcekur, pasi që për marrjen e Pëlqimit duhet që të organizohet dëgjim publik me banoret përreth pronës ku kërkohet marrja e pëlqimit.

Kërkesa nr.02/99 datë: 15.03.2021 të parashtruar nga Ruzhdi Begaj nga fshati Banjë, për Pëlqim Komunal për rregullim të dokumentacionit për biznes individual B.I.

Rrahim Morina: Kush jeni për që kjo kërkesë të trajtohet? Për nuk kishte, kundër 5, abstenime 1 Komiteti për Politikë dhe Financa pas shqyrtimit të kësaj kërkesë, përmes kësaj përgjigje e njofton palën se unanimit e ka refuzuar kërkesën e lartcekur.

Kërkesa nr.02/127 datë:23.03.2021, e parashtruar nga z. Hilmi Paqarizi nga fshati Dragobil.

Alban Krasniqi: Secilës kërkesë që na vjen mi dhanë akses atëherë po ja jep mundësinë deri në shtëpi me pas qasje në pronë shoqërore, e dikush për 2 metra si jepet kjo mundësi. Në këso raste duhet bëhen bashkë pronaret t'i lëshojnë hapësirat e tyre nëse jo ndryshe nuk mundet me ndodhë.

Rrahim Morina: Kush jeni që kjo kërkesë t'i përcillet kryetarit të Komunës për trajtim? Unanimit ish in për.

Ankesa nr.02/147 datë: 02.04.2021 të parashtruar nga KFF.Kijeva, KFF. Shqiponja, ShF.Talenti, ShF "Top Besa", ShF Drenoci, për orarin stërvitor në Stadiumin "Liman Gegaj" në Malishevë.

Alban Krasniqi: Vendimin që e ka miratuar kuvendi me herët e ka autorizuar Drejtorinë për Kulturë që ta bënë orarin në bashkëpunim me klubet.

Halil Morina: Janë bërë shumë klube ata duhet me u dakorduar.

Alban Krasniqi: Këto janë asete publike e nëse ekzekutivi se respekton vendimin e kuvendit nuk është ne rregull.

Hashim Vrenezi: Te merret Drejtoria për Kulturë me këtë ankesë.

Rrahim Morina: pas shqyrtimit të kësaj ankesë të parashtruar pranë këtij organi, përmes kësaj shkresës përcjellëse nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport kërkon që të shqyrtojë ankesën në fjalë dhe në bashkëpunim me Klubet sportive të bëjë zgjidhjen e orarit për zhvillimin e aktiviteteve sportive sipas vendimit të Kuvendit të Komunës nr.02/474 datë: 03.12.2020.

Kërkesa nr.02/133 datë: 26.03.2021 të parashtruar nga kryesia e fshatit Qypevë.

Alban Krasniqi: Ligji parasheh mbajtjen e debateve publike kur janë në pyetje këto raste, Pëlqimin ja ka dhënë Drejtori i Urbanizmit e ndërtimi si i tillë është i përhershëm, distance me vendbanim është e vogël është afër shtëpive, afër rrugës, sa kryer ndërrimi i destinimit të tokës duhet me ditë a ka pas ankesa para se mu jep pëlqimi.

Hashim Vrenezi: Sipas informative që kam nuk është fermë e pulave, është ndërtim statik personi ka dokumente që nuk është ndotës i ambientit.

Rrahim Morina: Kush jeni që ta rekomandojmë këtë kërkesë? Për ish in 2, kundër 2, abstenime 2.

Rrahim Morina: Me qenë se votimi është i barabartë atëherë vota ime shkon për me rekomanduar për kuvend.

Kërkesa nr.02/162 datë: 07.04.2021 të parashtruar nga Deputetet e Kuvendit të Republikës së Kosovës znj. Jetmire Vrenezi dhe z. Gani Krasniqi, për zyre në hapësirat e objektit të Komunës së Malishevës.

Hashim Vrenezi: Kërkesa si kërkesë është e drejtë por ne e kemi vendimin që kemi marrë për zyre të grupeve politike dhe pse me nda zyre tjera prapë. Në Prizren ka qenë skandaloze tash që kryetari i Komunës atje i ka larguar nga zyret që kanë pas partitë politike e tash këtu kërkojnë zyre.

Alban Krasniqi: Ne këtu jemi pajtuar për zyre, ata duhet me pas një hapësirë për zyre dhe ata kërkojnë që ajo zyre me kanë e të gjithë deputetëve që janë në Kuvend të Kosovës.

Halil Morina: Kjo i përket ekzekutivit e jo neve sepse se dimë a ka hapësira.

Rrahim Morina: Përmes një shkrese përcjellëse unanisht po kërkojmë nga Kryetari i Komunës që në lidhje me kërkesën e lartcekur të shqyrtojë mundësinë e gjetjes së ndonjë zyre brenda objektit të Komunës-Administratës Komunale sipas kërkesës në fjalë.

Kush jeni që këtë kërkesë ta përcjellim për zyrën e kryetarit të komunës? Për ish-in 5, kundër s'kishte, abstenime 1.

Kërkesa nr.02/56 datë: 06.04.2021 të parashtruar nga kryesia e lagjes së Tupanëve nga fshati Drenoc, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e një objekti të përbashkët për nevojat e Lagjes së Tupanëve nga fshati Drenoc.

Alban Krasniqi: Secili le ta din pavarësisht se si vendoset në Kuvend toka duhet të mbetet në pronësi të Komunës.

Rrahim Morina: Pas shqyrtimit të kërkesës së lartcekur, përmes një shkrese përcjellëse unanisht kërkojmë nga Kryetari i Komunës që në lidhje me kërkesën e lartcekur të bëjë zbatimin e procedurave të Ligjit nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

Kërkesa nr.02/103 datë: 16.03.2021 të parashtruar nga përfaqësuesit e Lagjes Hazrolli nga fshati Banjë, për caktimin një lokacioni për dertimin e një objekti të përbashkët (Odë), për nevojat e Lagjes Hazrolli.

Rrahim Morina: Pas shqyrtimit të kërkesës së lartcekur, përmes një shkrese përcjellëse unanisht kërkojmë nga Kryetari i Komunës që në lidhje me kërkesën e lartcekur të bëjë zbatimin e procedurave të Ligjit nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

Kërkesa nr.02/81 datë: 04.03.2021 të parashtruar nga Operatorët e Transportit Urban dhe Ndërrurban të Komunës së Malishevës.

Rrahim Morina: Komiteti për Politikë dhe Financa pas shqyrtimit të kërkesës se lartcekur të parashtruar pranë këtij organi dhe në mungesë të mjeteve financiare, përmes kësaj përgjigje e njofton palën se unanisht e ka refuzuar kërkesën në fjalë.

Kërkesa nr.06/66 datë: 30.03.2021 të parashtruar nga z.Murat Hoti me vendbanim në fshatin Carrallukë.

Rrahim Morina: KPF pas shqyrtimit të kërkesës së lartcekur, përmes kësaj shkrese përcjellëse unanisht kërkon nga Kryetari i Komunës, për trajtim të mëtutjeshëm në lidhje me kërkesën në fjalë

Kërkesa nr.04/348 datë: 19.04.2021 të parashtruar nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa, për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2019-2020 në vitin fiskal 2021.

Alban Krasniqi: Projektet janë kryer e ato mjete duhet të shfrytëzohet dikund tjetër e jo në projekte që kanë përfunduar.

Rrahim Morina: Kush jeni me rekomanduar këtë kërkesë për Kuvend? Për ish-in 5, kundër 1, abstenime s'kishte.

Kërkesa nr.02/178 datë: 14.04.2021 të parashtruar nga Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Shërbim Pronësor-Juridik, për rregullimin e parcelave brenda oborreve të shkollave.

Rrahim Morina: Kush jeni që kjo kërkesë të rekomandohet për Kuvend? Unanisht ish-in për 6 anëtarë prezent të KPF.

8. Shqyrtimi i Raportit të punës të Drejtorisë për Urbanizëm për periudhën Janar-Dhjetor 2020.

Rrahim Morina: Kush jeni që ky raport të rekomandohet për Kuvend? Unanisht ish-in për 6 anëtarë prezent të KPF.

9. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/170 datë: 08.04.2021 të parashtruar nga Shoqata e Gjahtarëve UJËVARA në Malishevë.

Alban Krasniqi: Kjo kërkesë duhet t'i drejtohet kryetarit të Komunës.

Hashim Vrenezi: Kjo është një shoqatë që merret edhe me mbajtjen e kafshëve të egra, unë mendoi se mire është me rekomanduar për kuvend.

Alban Krasniqi: Në këso kërkesa kryetari duhet me sjellë e jo një OJQ, nuk bën me ba shkelje në duhet me ditë a ka pas marrëveshje, çfarë aktivitete kryen.

Rrahim Morina: Në pra mundemi më kërkuar kontratën, një raport të punës për 10 vitet e fundit.

Kush jeni me rekomanduar për Kuvend? Për ishin 4, kundër 1, abstenime 1.

Kërkesa nr.02/167 datë: 08.04.2021 të parashtruar nga Klubi i futbollit të femrave “Shqiponja“ në Malishevë.

Alban Krasniqi: Jam që kjo kërkesë te rekomandohet për Kuvend.

Rrahim Morina: Kush jeni që kjo kërkesë të rekomandohet për Kuvend? Unanimisht ishin për.

Kërkesa nr.02/173 datë: 12.04.2021 të parashtruar nga Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Shërbim Pronësoro-Juridik, për shqyrtimin e të drejtave mbi trojet e ndara nga Kuvendi i Komunal në Malishevë.

Rrahim Morina: Lidhur me këtë kërkesë palët kur shkojnë të noteret po kanë problem sepse këta sipas dokumenteve që posedojnë janë vetëm shfrytëzues të atyre trojeve.

Muharrem Morina: Ata sipas dokumenteve që kanë nuk po kanë të drejtë t’i shesin ato troje, sepse i kanë vetëm në shfrytëzim.

Hashim Vrenezi: Nëse është kështu në s’kemi çka me qu në kuvend.

Alban Krasniqi: Kjo me sa dije ma se pari është vendosur nga kryetari i atëhershëm, pastaj nga kryeadministratori.

Rrahim Morina: Pas shqyrtimit të kërkesës se lartcekur të parashtruar pranë këtij organi, përmes kësaj përgjigje e njoftojmë se unanimisht se KPF e ka refuzuar këtë kërkesë pasi që nuk është kompetent për të vendosur lidhur me kërkesën në fjalë.

Kërkesa nr.02/171 datë:12.04.2021 të parashtruar nga Kryesia e Lagjes Avdullahovit-fshati Carrallukë, për bashkëfinancimin në realizimin e projektit “ Ndërtimi i objektit të përbashkët me rastin e pritjeve të ndryshme për lagjen Avdullahovit në fshatin Carrallukë.

Rrahim Morina: Pas shqyrtimit të kësaj kërkesë se lartcekur të parashtruar pranë këtij organi, në duhet t’i njoftojmë së unanimisht KPF e ka refuzuar kërkesën në fjalë pasi që Kuvendi i Komunës së Malishevës në këtë legjislature nuk ka ndarë mjete për ndërtimin e objekteve të përbashkëta (Odave), për pritje dhe ceremoni të ndryshme neper lagje dhe fshatra të Komunës së Malishevës.

Kërkesa nr.02/175 datë: 12.04.2021 të parashtruar nga Shoqata e të verbërve në Malishevë.


Rrahim Morina: Pas shqyrtimit të kërkesës se lartcekur të parashtruar pranë këtij organi, përmes kësaj përgjigje i njoftojmë se unanimisht e ka refuzuar kërkesën në fjalë, pas që kuvendi i Komunës ka ndarë mjete financiare për blerjen e mjeteve arsimore (mjete konkretizimi).

Rrahim Morina: Ju përsëndes të gjithëve, ju falënderoj për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 16:20

Procesmbajtësi

Naim Avdijaj jur. i dip



Kryesuesi i Kuvendit

Rrahim Morina

